



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për:	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Rahim Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Date: 11.02.2019
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 020-146
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/85 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të Pishinës Publike në Fshatin Banjë
I miratuar më datë: 31.01.2019
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.02.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj , gradonačelnik Opštine Mališevo Rrahim Morina , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo		
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini		
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>B.F. Todosijević</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, <i>Rozafa Ukimeraj</i>		
Od:	Venera Çerkini, rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS <i>Venera Çerkini</i>	Datum,	11.02.2019
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo	Br.	020-146
Vrsta akta:	Odluka		

Poštovani gradonačleniče,
 Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 02/85 za davanje na kratkoročno korišćenje javnog bazena u selu Banje
Usvojena dana, 31.01.2019. godine;
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 11.02.2019. godine;

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 85

Datë: 07.02.2019

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja d, nenit 17 dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), bazuar në nenin 5 të Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17, dhjetor 2012), nenin 4 të Rregullores QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, në bazë të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në vazhdimin e mbledhjes së I (parë) të vitit 2019 të mbajtur me datë:01.02.2019 merr këtë:


V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PISHINËS PUBLIKE NË
FSHATIN BANJË

1. Miratohet kërkesa nr.01/48 e datës: 21.01.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënien në shfrytëzim të Pishinës publike në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës.
2. Obligohet komisioni për vlerësimin e ofertave që në pajtim me nenin 7 të Ligjit nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregulloren QRK nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, t'i kryej procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër.
3. Afati i dhënies në shfrytëzim caktohet të jetë afatshkurtër për dy vite (2019-2020), ndërsa çmimi minimal me këtë vendim caktohet të jetë 20,000€ (njëzetmijë euro), për secilin vit, ndërsa në procedurë të ankandit do të përzgjidhet oferta ekonomikisht më e favorshme për Komunën.
4. Pagesa e mjeteve për vitin 2019 dhe 2020 caktohet të bëhet në dy këste dhe atë:
 - 4.1. pagesa e mjeteve për këstin e parë të vitit 2019 në shumën prej 50% të mjeteve duhet të bëhet para nënshkrimit të kontratës, ndërsa kësti i dytë në shumën prej 50% duhet të bëhet jo më larg se data: 30.09.2019.
 - 4.2. pagesa e mjeteve për këstin e parë të vitit 2020 në shumën prej 50% të mjeteve duhet të bëhet me datën: 30.03.2020, ndërsa kësti i dytë në shumën prej 50% duhet të bëhet jo më larg se data: 30.09.2020.
5. Me këtë vendim do të lirohen nga pagesa e hyrjes dhe e shfrytëzimit të Pishinës këto kategori: Familjet e ngushta të Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, pensionistëve dhe të gjitha Klubet e sportit në Malishevë.
6. Mënyra e shfrytëzimit dhe menaxhimit të lokacionit të lartcekur me këtë vendim do të rregullohet sipas procedurave të parapara ligjore.
7. Autorizohet Kryetari i Komunës që me rastin e nënshkrimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim, kohën e shfrytëzimit si dhe për pagesat të kërkoj policën e sigurimit dhe garancionit bankar.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, përmes organeve kompetente.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Drejtore të KK-së
Arkivit të Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



Kryetari i Komunës

Nr. 01/

Datë: 15/01/2019

PRALIM * 21-01-2019
ACUEREL
PRILIM
Nr. Nd.Bi. 01-48



Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z.Rrahim Morina.

Datë: 15.01.2019

Kopje: Arkivit të komunës

Lënda: Kërkesë për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për procedurë të mëtejme për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK-Malishevës.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 5 dhe në bazë Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 4, si dhe kërkesës së drejtorisë për shërbime publike nr.09/05/-MB. dt.14.01.2019, kërkojë nga ju që të merrni vendimin për iniciimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pishinës publike në fshatin Banjë, KK- Malishevës.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës publike sipas Ligjit të cekur, është krijimi i mundësive për të hyra publike në buxhetin e KK- Malishevës, ndërsa për kohëzgjatjen, çmimin për një vit mbetet në kompetencën tuaj të përcaktoni.

Kërkesës ja bashkëngjisim Certifikatën pronësore, kopjen e planit të pjesës së ngastrës së cekur si më lartë.

Ju faleminderit për mirëkuptim !

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT: P-72316001-01692-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: Data dhe koha e fshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: Komuna / Opština / Municipality: Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastrol Zone: Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office:	338-2019 07.02.2019 - 10:11 Malishevë / Mališevë / Malishevo / Malishevo DANIË / DANIJA / BAJE Malishevë / Mališevë / Malishevo / Malishevo
---	---

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cat. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i prorisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Spërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72316001-01692-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Kard.	5147	Vendim Nr.01-01/13 dt.11/02/2013		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednost adresa Address Details	Krijar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
BAZHILINA-TE BAZENI/BAZHILINA-TE BAZENI		BAZHILINA-TE BAZENI		




A.2 LLOJË SHËRVTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shërvetimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shërvetimi aktual i parcelës Trenutna koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bojësi/Pojësi/pasture Bojësare/Pojësi/pasture	Kullësor/Pashjësi/pasture	Kullësor II Klasës 2/Pashjësi 2 Klase/2nd Class Pasture	5147

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licat broj ID. No.	Vendbanimi Prethvaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hafesitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuroar Ažurirano Updated
Posejdim individual / Individualna Drzavina / single possessor	P.SH.KUVENDI KOMUNAL	KCID2300096	MALISHEVE / MALISEVO / MALISHEVË /			1/1	Vendiin Nc 01-01/13 dt. 11/02/2013	

DIRETORIAEnglish/



Pronari, Shfrytëzuesi / Owner, Possessor:



Data: 07/02/2019





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Drejtoria e Shërbimeve Publike

Nr. i prot: 09/25-MB

Datë: 16-01-2019

Nga: Drejtori i DSHP, z/Milazim Morina

Për: Kryetarin e Komunës, z/Ragip Begaj.

LENDË: Këkesë për iniciimin e procedurave për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtë të pishinës publike në fshatin Banjë

I nderuar Kryetari, kërkojmë nga ana e juaj që të inicioni procedurat për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtë të pishinës publike në fshatin Banjë, ngastra kadastrale nr. 72316001-01692-1, në sipërfaqe prej 0,5147 ha, zona kadastrale Banje Komuna Malishevë, e që realizohet përmes konkurrencës së hapur publike dhe procedurave të parapara duke u bazuar në Ligjin nr. 04/1-144.

Kryetari i Komunës së Malishevës ka nënshkruar një kontratë për dhënjën në shfrytëzim afatshkurtë 1 (një) vit të pishinës publike në fshatin Banjë me datë 22.06.2018 me nr. Protokoli 01/934, e që kjo kontratë është valide deri me datë 31.12.2018, prandaj këkresa jonë është që të inicohen sa më herët procedurat e përmendura më lartë në mënyrë që pishina të fillojë së funksionuari në fillim të sezonit veror.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË



Drejtoria e Shërbimeve Publike

Nr.i prot: 09/06-MB.

Datë: 16.06.2019.

Nga: Drejtori Shërbimeve Publike z.Milazim Morina

Për: Kryetarin e Komunës z.Ragip Begaj.

Lënda: Raport i shfrytëzimit të Pishinës në Banjë për vitin 2018.

Pas shpalljes së ankandit publik për dhënjen në shfrytëzim të Pishinës së Banjes është bërë përzgjedhja e ofertusit. Si ofertuse është zgjedhur z.Haxhi Hazrolli nga Banja me të cilin Kryetari i Komunës z.Ragip Begaj nënshkruajn kontratën numer:01/934 datë 22.06.2018 me vlerë prej:31,030.00 euro.Pjesën prej 15,000.00 euro e ka bërë me datën 22.06.2018 sipase listës së qiramarrësve nr:7 nga DEF, ndersa pjesën tjetër prej 16,030.00 euro e ka siguruar me policen e sigurimt numer:67886 tek kompania "ELSIG" Prishtinë. Kryetari formon komisionin për pranimdorëzimin e pishinës.

Komisioni i pranimdorëzimit: Demush Krasniqi, Sahit Kafexholli, Nehat Krasniqi ka hartuar procesverbalin nr:28/06/2018 datë:23.06.2018 i pranishëm edhe shfrytëzusi i ri z.Haxhi Hazrolli. Sipase këti procesverbali kemi këtë gjendje të pishinës:

- a) Tualetet dhe zhfeshtorët nuk jan ne funksion të plotë.
- b) Tushi për pasrim nuk funksionon.

Pas këti konstatimi është urdhëruar shfrytëzusi i ri z.Haxhi Hazrolli të merr këto masa:

1. Të riparoj këto mangësi të cekura më lartë.
2. Pasrtrimin dhe klorizimin e pishinës.
3. Të këtë stafin (zhytësit) që kujdesen për sigurinë e pushusëve dhe ti përmbahet pikave të kontratës.

Shfrytëzusi e ka pranuar shfrytëzimin e pishinës me datën 23.06.2018 dhe ka filluar ushtrimin e aktivitetit për të cilin e ka marr pishinën. Gjatë periudhes së shfrytëzimit i

është kërkuar në mënyrën miqësore të zgjidhjes së pikave të kontratës për pagesën e kisteve. Edhe pas këtyre përpjekjeve kontraktusi i shfrytëzimit të pishinës nuk ju ka përmbajtur afatit të pagesave për pjesën prej 16,030.00 euro për të cilën janë marrë këto veprime:

1. Vërejtje me numer:07/161 datë 18.12.2018 nga Drejtoria e Inspektoratit të cilën refuzon pala ta pranon.
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkon sipas njoftimit numer:09/122 datë 19.12.2018 ekzekutimin e polices së sigurimit nr:67886 datës 22.06.2018 nga kompania "ELSIG" Prishtinë në emër të Haxhi Hazrollit ,gjithashtu është njoftuar edhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Komisioni i pranindorëzimit: Demush Krasniqi, Sahit Kafexholli me datën 31.12.2018 në prezencën e Haxhi Hazrollit kanë bërë pranimin e pishinës nga shfrytëzuesi sipas procesverbalit nr:38/12/2018 datës 31.12.2018 pasi kjo datë është afati i fundit të shfrytëzimit.

Sipas këtij procesverbal kemi këtë konstatim:

1. Janë përmisuar defektet që i kemi hasur sipas procesverbalit nr:28/06/2018 datë 23.06.2018.
2. Nuk kemi hasur diçka për ta theksuar që nuk funksionon dhe gjendja është në rregull.

Shfrytëzuesi Haxhi Hazrolli nga Banja ka bërë vetëm pagesën prej 15,000.00 euro, ndërsa obligimi mbetur papaguar sipas kontratës është shuma prej 16,030.00 euro për të cilën kemi kërkuar ekzekutimin e polices së lartëcekur.

Këti raporti i bashkangjesim:

1. Procesverbalin nr:28/06/2018 datës 23.06.2018 të komisionit të pranindorëzimit
2. Vërejtjen nga Drejtoria e Inspektoratit nr:07/161 datës 18.12.2018.
3. Njoftimin për ekzekutim të polices së sigurimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike nr:09/122 datës 19.12.2018.
4. Lista e qiramarrësve nga DEF datës 17.12.2018.
5. Procesverbalin nr:38/12/2018 datës 31.12.2018 të komisionit të pranindorëzimit